



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe  
Mbledhja nr. 33/18  
Prishtinë, më 17.10.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Enver Hoti.

Pjesmarresit tjerë: Blerta Bejtullahu nga Zyra e BE-së, Ardita Hajra NGO Aktiv, Miloš T. nga NGO Aktiv, Zeljko Tvrdiscic nga Radiokontakt, Muhamet Spahiu – Këshilltar në GP AAK, Albulena Avdiu – Gazetare nga Ekonomia Sot, Albulena Mavraj – Gazetar nga Epoka e Re, Dren Ajeti nga Klubi i Prodhuesve, Shpresë Sejdiu nga GP PSD, Vatra Qehaja nga GP VV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18 dhe 26 shtator 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-054 për Gjykatat dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-059 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
8. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona;
9. Të ndryshme.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari:** Konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës unanimitet pa ndryshime.

#### 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18 dhe 26 shtator 2018

**Kryetari:** Konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18 dhe 26 shtator 2018, unanimitet pa vërejtje.

#### 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-054 për Gjykatat dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

**Kryetari:** Theksoi se Projektligji, por edhe amendamentet e komisionit funksional përmbajnë implikime buxhetore. Unë kam kërkuar një vlerësim paraprak nga Ministria e Financave (MF) lidhur me koston shtesë buxhetore dhe kam marrë një përgjigje nga MF se kërkohet kohë më shumë për të bërë vlerësimin e koston shtesë. Në rrethana të tilla që nuk e dijmë koston shtesë të amendamenteve të propozuara, unë mendoj se duhet ta shtyjme këtë pikë deri sa të marrim një vlerësim nga MF. Ne e kalojmë periudhën dhjetë ditore si komision kryesorë, por nuk mund të votojmë apo të nxjerrim rekomandim pa e ditur koston. Prandaj, propozoj të shtyjme në një mbledhje tjetër.

**Arberi Nagavci:** Unë pajtohem me propozimin për shtyerjen e shqyrtimit të kësaj pike. Unë jam konsultuar edhe me anëtarët e komisionit për legjislacion lidhur me koston shtesë që krijojnë amendamentet dhe kisha kërkuar t'ia dërgojmë një kërkesë Ministrisë së Financave që më së voni para mbledhjes së ardhshme të na sjellin një vlerësim për implikimet buxhetore që ka zbatimi i këtij ligji, që pastaj ta shqyrtojmë dhe jo ta shtyjme më tutje.

**Kryetari:** Propozoj që të shtyhet shqyrtimi i Projektligjit dhe njëkohësisht Komisioni të kërkojë nga MF, të dërgojë vlerësimin e ndikimit buxhetor që të mund të radhitet për shqyrtim PL në mbledhjen e radhës.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitet nxori këtë

#### Përfundim

1. Projektligji nr.06/L-054 për Gjykatat dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.
2. Kërkohet nga Ministria e Financave të bëjë vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe financiar të amendamenteve të komisionit funksional dhe Opinionin me shkrim t'ia dërgojë Komisionit.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

**Kryetari:** Theksoi se në bazë të Deklaratës për vlerësimin e ndikimit buxhetor të përgaditur nga MF, PL përmban një kosto shtesë buxhetore. Por pas konsultimit me MF dhe Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë zbatuese e ligjit është kuptuar se kostoja shtesë buxhetore është përfshirë në projeksionet buxhetore për vitin 2019. Ndërsa, amendamentet nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

**Arbërie Negavci:** Theksoi se për aq se e kemi analizuar Projektligjin kemi parë se është një buxhetim prej 240,000 euro i planifikuar për vitet 2017-2018, deri sa e dijmë se ligji në fuqi në të kaluarën nuk është zbatuar dhe duke marrë parasysh edhe kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe institucionale duket se edhe ky ligj do të jetë i pazbatueshëm. Unë mendojë që kishte qenë mirë që propozuesi të na sjell arsyet pse nuk është zbatuar ligji i mëparshëm, përpara se të aprovohet ligji i ri. Mos të miratojmë një ligj që paraprakisht dihet që do të dështoj në zbatim.

**Kryetari:** Ligji në fjalë nuk është në kuadër të kompetencave të komisionit tonë, por të komisionit për zhvillim ekonomik. Ne e shikojmë vetëm koston buxhetore. Kostoja buxhetore shtesë e vlerësuar fillimisht me Deklaratën Financiare, tani në fazën e përgaditjes së buxhetit 2019 është përfshirë sipas informatave që kanë dhënë dy ministrat dhe propozojë që të procedojmë tutje se Projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

**Kryetari:** Në bazë të Deklaratës Financiare të MF, është thënë se projektligji përmban kosto shtesë buxhetore prej 1.87 milion euro dhe pas konsultimeve që janë zhvilluar me përfaqësues të Departamentit të Buxhetit të MF është mësuar se kostoja shtesë buxhetore është përfshirë në planifikimet buxhetore 2019-2021. Ndërsa, amendamentet nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore. Propozojë që të procedojmë tutje se Projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për Projektligjin nr.06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

## **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-059 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

**Kryetari:** Në bazë të Deklaratës Financiare të MF, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore.

**Naser Osmani:** E kuptoj që jemi komisioni që e shyrtojmë pjesën financiare, por si deputet nuk kufizohemi vetëm në këtë çështje. Konsiderojë se çështja që është rregulluar me amendamentin 1 të propozuar nga komisioni funksional, nuk është trajtuar si duhet. Ne Kosovë qarkullojnë një numër i automjeteve që janë të vjetra dhe përveç aspektit të ndotjes së ambientit, ne dimë se kjo verë ka qenë shumë e përgjakshme për shkak të aksidenteve dhe njëra nga arsytet ka qenë edhe për shkak të automjeteve jo në gjendje të rregullt dhe me defekte teknike. Prandaj, propozimi që me u rritë vjetërisa e veturave në qarkullim në 15 vite është një kalkulim jo në interes të shëndetit të njerëzve. Prandaj, propozojë që amendamentin 1 të komisionit funksional të kundërshtojmë dhe të mos e pëkrahim.

**Dardan Molliqaj:** Theksoi se duhet të ndaj shqetësimin e njëjtë me z. Osmanin, por unë do ti theksojë elemente të tjera që janë shumë të rëndësishme. Ne jemi të vetëdijshëm për ndotjen e ambientit, që sidomos gjatë sezonit të dimrit ajri në Prishtinë është shumë i ndotur, kjo edhe për shkak të numrit të madhë të veturave që qarkullojnë një kryeqytet, dhe e kemi rastin kur Komuna ka vendosur kufizimin e qarkullimit të veturave me orar të caktuar brenda qytetit për disa ditë dhe kjo ka pasur efekte pozitive në rënien e ndotjes së ambientit. Por, jo vetëm në Prishtinë, por edhe në krejt Kosovën është problem serioz ndotja e ambientit që po ndikon në shëndetin e njerëzve. Në këtë drejtim rritja e vjetërisë së veturave në qarkullim është në kundërshtim edhe me standardet e BE-së, sa i përket çështjes së ambientit. Nuk besojë që është në interes të askujt që kjo të ndodhë, përveç ndonjë interesi financiar. E di që qytetarët dëshirojnë me ble vetura të lira, por besojë se është investim i gabuar edhe për vetë ata, për shkak se vjetërsimi i automjeteve i shkakton dëme secilit në Kosovë.

E di që roli i komisionit tonë në këtë rast është vlerësimi i kostos buxhetore, por është në interes të mos e pëkrahim amendamentin 1 të propozuara nga komisioni funksional dhe të ndikojmë edhe në publik që me u rritë presioni që mos me kalue kjo çështje as në seacnë sepse nuk është i drejtë si duhet.

**Mërgim Lushtaku:** Projektligji ka qenë iniciativë e imja dhe e përkrahur nga deputetët tjerë. Sa i përket vjetërsisë së veturave, në bazë të hulumtimeve që janë bërë, në BE nuk ka ndalesa apo kufizime të qarkullimit të veturave sipas viteve. Ne jemi bazuar edhe në traspozimin e legjisllacionit të BE-së dhe propozimi nuk është në kundërshtim me atë. Pra, si inicues kamë qenë shumë i kujdesshëm që ligji të mos jetë në kundërshtim me legjisllacionin e BE-së, sa i përket aspektit ambiental. Këto janë standarde evropiane e jo qe i kam shpikur vetë. Qëllimet e ndryshimeve janë të aspektit social, pasi që blerja e veturave të reja, po ndikon në buxhetin e familjet tona kosovare. Përdersia nuk është në kundërshtim me legjisllacionin e BE-së, unë nuk e shoh të arsyeshme që mos me mbështet këtë amendament. I kam shikuar edhe vendimet e policisë për çështjen e sigurisë në komunikacion dhe shumica e aksidenteve ndodhin për shkak të mos respektimit të rregullave të komunikacionit e nuk ka të bëjë me çështjen e vjetërsisë së veturave.

**Naser Osmani:** Logjika me bërë Kosovën depo nuk është e shëndetshme dhe faktikisht jemi duke bërë grumbullimin e teneqeve dhe mendojë se është mirë e rregulluar në ligj që vjetërsia e veturave është e kufizuar në dhjetë vjetë dhe sa më e re makina, dogana është më e lirë dhe sa më e vjetër makina dogana më e lartë. Ne tani pas nënshkrimit të marrëdhënieve kontraktuale me BE-në, sa i përket doganave për makina duhet liruuar për shtetasit e BE-së dhe ka sjell vendime për më i heq makinat e reja dizel. Prandaj, makinat e vjetra dhe të pamirëmbajtura mirë e rrezikojnë jo vetëm jetën tonë, por edhe të tjerëve. Unë e pëkrahu amendamentin 2, ndërkaq e kundërshtojë amendamentin 1.

**Dardan Molliqaj:** Unë po dua me tregue se Partia Social Demokrate në fokusin e parë e ka mirëqenien e njerëzve. Ndërsa, partitë e djathat e kanë synim parësor investimet se sa efektet anësore që prodhojnë ato. Po me vjen mirë qëndrimi i z. Osmanit se nuk është prioritet vetura në Kosovë, por shëndeti i njeriut dhe ruajtja e ambientit.

**Safete Hadërgjonaj:** Të themë të drejtën unë jam më e shqetësuar për doganën e lartë për importin e makinave në Kosovës, që nëse krahasojmë shtetet e rajonit është më e larta dhe pikërisht për shkak të doganës, disa qytetar mendojnë me i regjistruar makinat në Shqipëri, Maqedoni apo Mal të Zi. Sa i përket çështje që po diskutojmë, pavarësisht se si deklarohen partitë, të gjithë po prokalojmë dhe zhvillojmë politika sociale dhe po shkojmë nga e majta, kjo edhe për shkak të rrethanave dhe situatës në vend. Unë nuk jam e interesuar me e shëndrrue Kosovën në depo të makinave të vjetra e as me ndotë ambientin, por ka edhe makina që është e re e blerë, por nuk funksionon mirë dhe kontrollën nuk e ka të mirë dhe si rezultat e ndotë ambientin më shumë se një veturë e cila është në gjendje të rregullt dhe mbi 15 vjetë e vjetër.

Unë mendojë që duhet të fuziqohet çështja e kontrollit të këtyre makinave dhe të bëjmë një sistem të mirë të kontrollit dhe makinat të cilat e ndotin ambientin mos të lejohen në çarkullim. Prandaj, nëse funksionon sistemi i kontrollit dhe nëse është mbi 15 vjetë një makinë dhe është në gjendje të rregullt dhe nuk e ndotë ambientin, pse mos me t'ia mundësojmë blerjen e tyre nga qytetarët.

**Blerim Kuçi:** Kjo çështje në aspektin funksional është diskutuar në komisionin e fushës dhe ne duhet ta shohim aspektin buxhetor. Qytetari është ai që përcaktohet çfarë veture blenë dhe ne duhet të mundsojmë gamën më të gjërë të përzgjedhjes. Nëse propozimi nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, mos po mundohemi me nxjerr apo me bë improvizime më shumë se që duhet. Unë propozojë me mbyll këtë debat dhe të japim vlerësimin si komision në aspektin buxhetor të fushës që jemi përgjegjës dhe të shkojmë më tutje. Nëse dojmë me riciklu këtë debat e kemi seancën e debatujm aty.

**Mërgim Lushtaku:** Ne e dimë shumë mirë mirëqenien sociale të qytetarëve të Kosovës dhe standardet e tyre dhe ne po kërkojmë nganjëherë standarde më të medha se të Evropës. Në BE është e rregulluar kjo çështje dhe nuk ka kufizime në vite dhe ka hapërsirë më të madhe të blerjes së veturave. Ne do të kërkojmë standarde karshi çdo produkti në procesin e integritimit në BE, dhe në këtë drejtim me këtë projektligj ne jemi në linja të qarta dhe nuk kemi shkelur asnjë direktivë të BE-së.

**Dardan Molliqaj:** Siç e dini z. Lushtaku edhe ligji aktual përmban standardin e aplikimit të euro 4, por Kosova nuk a ke mundësin me zbatue një gjë të tillë. E dyta, nëse është me u zgjerue gamën e përzgjedhjes për qytetarët, logjika e heqjes së kufizimit nuk qendron sepse ka rregullime që i përkatojnë këto çështje. E treta, që është me interes ka të bëjë edhe me reagimin e Zyrës së BE-së, që unë shumë shpesh nuk e kam përfillur qëndrimin e tyre, por në këtë rast znj. Apostollova ka ndalur kundër këtij propozimi, sikurse edhe Ambasadori Gjerman, që mendojë se kanë të drejtë sepse nuk një çështje politike, por rregullim i brendshëm i çështjes së ruatjes së ambientit.

Besojë që e kam të qartë se Partia Demokratike që e po e shtyn me kaq ngulm ka interesa të tjera financiare. Unë nuk mundem me e fshehtë gjendjen ekonomike dhe sociale në Kosovë dhe kështu është edhe për shkak të politikave që ka bërë PDK dhe partitë tjera që kanë qenë në qeverisje. Nuk është në rregull me ndryshue ligjin që me sjell vetura të vjetra, me dëmtue ambientin për të përfituar individ të caktuar.

**Arbërie Nagavci:** Theksoi se edhe unë mendojë se rëndësia e debatit është që të kuptohet se qëllimi i vërtet me këtë projektligj është që të shtyhen këto agjenda të interesave të caktuara. Unë e kisha ftue deputetin Lushtaku dhe gjithë neve deputetëve tjerë, që nëse mendojmë për aspektin ekonomik dhe

social të qytetarëve kishte me qenë mirë me pa çështjen e homologimit të veturave sepse qytetarët tanë paguajnë më së shumti mbi gjitha vendet e BE-së, dhe për ma tepër e dimë se kompania e cila e kryen këtë proces ka monopol në këtë treg, që është në kundërshtim edhe me Kushtetutën, që perfitojn kompanitë e caktuara. Nëse vërtet po mendojmë në çështjen e qytetarëve duhet pasur parasysh parasegjithash shëndetin e tyre, por edhe për mirëqenien e tyre duke ndikuar në koston e çmimeve dhe përmirësimin e standadit të jetesës.

**Blerim Kuçi:** Unë fillimisht kam pasur një kundërshtim me Z. Lushtaku për Projektligjin, por jemi sqaruar. Mirëpo ajo që nuk po e kuptojmë, në çoftë se për shkak të mos zabtimit të mekanizmave tjerë nuk duhet votuar një ligj më duket një llojë demagogjie. Ne duhet pasur parasysh standarden e jetesës brenda vendit dhe është e rëndësishme që të mos jemi në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

**Safete Hadërgjonaj:** Theksoi se ne analizojmë koston buxhetore të ligjeve dhe amendamenteve të komisioneve tjera funksionale. Ky material që na ka ardhur nuk ka kosoto buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës, prandaj ju kisha lut lidhur me këtë çështje të mos bëjmë politikë në komisionin tonë sepse edhe nëse e votojmë kundër nuk e dijim se si e bëjmë raportin, sepse na duhet me thënë se a ka implikime apo jo buxhetore. Përkundrazi ky ligj rrit buxhetin. Ndërsa kur shkon në Kuvend projektligji për shqyrtim, mund të votojmë si mendojmë ne.

**Mërgim Lushtaku:** I kutpojë znj. Apostolova dhe Ambasadorin Gjerman për shqetsimet e tyre, por kërkesat e tilla nuk është mirë të bëhen që kalojnë edhe standardet e vendeve të tyre ku jetojnë.

**Kryetari:** Në bazë edhe të konsultimit me administratën lidhur me procedurat, në bazë të asaj që u diskutua dhe propozua, si kryetar i komisionit, jam i obliguar ti hedhë dy propozime në votim: Propozimi i parë i deputetit Naser Osmani se Projektligji nuk përmban implikime buxhetore, as amendamentet e komisionit funksional, me përjashtim të amendamentit 1, të cilin komisionit nuk e përkrah. Përndryshe, unë e përkrahu mendimin e znj. Hadërgjonaj se duhet zvogëluar doganën dhe akcizën e veturave, por mos ta dëmtojmë ambientin dhe mos ta shëndrrojmë Kosovën në depo, prandaj përkrah propozimin e z. Osmani.

Unë e hedh në votim propozimin e z. Osmanit, sipas së cilit komisioni për buxhet dhe financa vlerëson se Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë, as amendamentet e komisionit funksional, me përjashtim të amendamentit 1 të cilin Komisionit nuk e përkrah. Me 5 vota Për, 2 Abstenime dhe 2 Kundër, kalonë propozime i z. Osmani.

**Safete Hadërgjonaj:** Së pari duhet me hudhë në votim pikën e parë se Projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë dhe jo t'iu imponohet anëtarëve të komisionit se fillimisht votohet propozimi se nuk miratohet amendamenti 1. Kjo është palidhje dhe po bënë shkeljen tënde.

**Kryetari:** U votue propozimi i z. Osmani, i cili morri votat e nevojshme dhe kjo çështja u krye. Nuk ka arsyt më për votim tjetër.

**Dardan Molliqaj:** Sa i përket çështjes procedurale, nëse jemi komision funksional siç po thoni ju, atëherë pse duhet me votu. Nëse kryetari edhe procedurat komisionit kërkojnë votime për secilën çështje kjo nënkupton që ne mundemi mos me e votu edhe kur ska implikime buxhetore. Po më duket se interpretimin e kenë shumë të ngushtë se po të kishte qenë siç thoni ju dhe ne kemi të drejtë si të duam të votojmë.

**Safete Hadërgjonaj:** Në komisionin tonë ne i shqyrtojmë projektligjet dhe amendamentet në aspektin e koston buxhetore dhe financiare dhe nëse Projektligji nuk ka kosto buxhetore atëherë si ke me votu. Ju mund të votoni si të doni, por duhet dhënë deklarinimin si komisioni kryesorë që jemi. Në komisionin për

buxhet dhe financa le te ruhet tradita e mirë e punës qysh e kemi per obligim në bazë të Rregullores se Kuvendit dhe mos ta sjellim politikën brenda komisionit.

**Blerim Kuçi:** Ne kemi pasur një praktikë të mirë deri më tash dhe sa kam biseduar me kolegë që kanë qenë në këtë komisioni më herët. Nëse po doni ju zoti kryetar me krijue këtë praktikë të tillë të votimit të amendamenteve të veçanta që nuk janë të fushës së caktuar, atëherë e ke qel një rrugë dhe nuk bëre mirë. Kjo shkojë por nuk ka kuptim se vështirësohet funksionimi i komisionit.

**Kryetari:** Nuk është hera e parë që kemi votuar mendimet e komisionit jashta fushës sonë. Kështu që kemi drejtë që brenda mandatit si deputet me votue të lirë si mendojmë ne. Sa për informacion as Komisioni për Integritet Evropian nuk e ka përkrah këtë amendament. Shkojmë kështu në seancë sië votojë komisioni se PL nuk përmban implikime buxhetore shtesë por mendimi i shumicës se komisionit është se nuk e përkrah amendamentin 1 të propozuar nga komisioni funksional dhe as edhe seanca vendos.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me Pesë vota Për, dy Abstenime dhe dy Kundër, nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.06/L-064 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Lutfi Zharku, për Projektligjin nr.06/L-064 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e përkrahu amendamentin 1, të propozuar nga Komisioni Funksional dhe rekomandoi që i njëjti të hiqet.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

**Safete Hadergjonaj:** Theksoi se në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetore dhe financiar të bërë nga Departmaneti i Buxhetit të MF, Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë. As amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Me qëllim të harmonizimit të këtij ligji me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, sa i përket hartimit të buxhetit dhe procedurave në përgaditjen e tij, propozojë që të bëjnë një amendament në paragrafin 1 të nenit 17, si në vijim:

Neni 17, paragrafi 1, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Nevojë për të bërë këtë ndryshim është për faktin se nëse e lëmë siç është shkruar në PL që Këshilli harton buxhetin dhe e procedon në Kuvend, kjo lënë hapërsirë që mos të dërgojnë buxhetin fare në MF dhe si ti tillë nuk bëhet pjesë e buxhetit të Kosovës dhe pastaj ka problem me shqyrtue dhe miratue buxhetin e Këshillit. Përmes amendamentit të propozuar, Këshilli Gjyqësor e dërgon buxhetin në MF, dhe pastaj autoriteti i fundit që vendos për buxhetin e tyre është Kuvendi. Kjo procedurë është në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, sa i përket përgaditjes së kërkesave buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, zëvendëskryetarja e parë, konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të paragrafit 1 të nenit 17.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin .06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si në vijim:

#### **Amendamenti 1**

Neni 17, paragrafi 1, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, nga deputetja Albulena Haxhiu, deputeti Hajdar Beqa dhe deputetja Fitore Pacolli, për Projektligjin nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
4. **Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona**

**Safete Hadërgjonaj:** Theksoi se si komision kemi formuar një grup punues që ka pasur për qëllim të analizojë kërkesën e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe të dal me një propozim për komisioni lidhur me caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona.

**Mërgim Lushtaku:** Si grup punues e kemi shqyrtuar kërkesës e Agjencisë dhe nuk ka qenë e lehtë të dilet me një propozim për caktimin e kompensimit të anëtarëve në fjalë. Ne kemi marrë për bazë edhe praktikën e kaluar si janë caktuar pagat apo kompensimet me anëtarët e agjencive të pavarura, por kemi pasur parasysh edhe nivelin e pagave që kanë pasur anëtarët e këtyre komisioneve në këtë Agjenci përpara. Në bazë të kësaj ne kemi rekomanduar që t'iu caktohet kompensimi prej 700 euro bruto në muaj për një mbledhje të caktuar dhe ajo që është me rëndësi të theksohet se nuk mundem me u pague më shumë se dhjetë seanca brenda një viti.

**Arbërie Nagavci:** Unë prita të shoh se cila është arsyeshmëria e vlerës së propozuar, por është interesante me dëgjue kryesuesin e grupit punues z. Mërgim që tha se kompensimi prej 700 euro për një mbledhje është bazuar edhe në praktikën e mëhershme. Përderisa vlera prej 700 euro është dyfishi i pagës mesatare e shumë herë më e madhe se paga minimale në Kosovë. Kjo është pak sa paraoksale sepse pak me herët folët për ndryshimin e viteve të mundësisë së blerjes së vjetërsisë së veturave duke pasur parasysh aspektin social për qytetaret, ndërsa është propozuar që një anëtar të komisionit me i caktue pagë 700 euro, që vlerësojë së është shuma e madhe dhe nuk ka një bazë të ligjore dhe unë e konsideroj që propozimi i grupit punues është i papranueshëm.



**Blerim Kuçi:** Ne kemi bërë analizat dhe krahasimin e natyrës së punës së këtyre komisioneve dhe krahasimet me komisionet tjera të ngjashme. Këto komisione zhvillojnë një proces të punës të barabartë si gjykatësit, pasi që merren me shqyrtimin e lëndëve të tëra të fushës dhe zhvillojnë takime që mundën me zgjatë disa sesione. Ne kemi kufizuar mundësinë e pagesës në 10 sesione brenda një viti.

**Dardan Molliqaj:** Kur të miratohet ligji për paga, do të duhej të rregullohej çështja e pagave në nivel shtetëror, i cili për aq sa e kam parë është dukshëm më i mirë se si ka qenë situata deri më tash. Sigurisht që do të kemi propozime dhe amendamente si grupe parlamentare dhe do të përmirësojmë atë. E dyta, unë mendoj se nuk guxojmë me i trajtue njësojë institucionet dhe agjencitë që kanë përgjegjësi të madhe me ato të zakonshme. Agjencione që kanë punë më shumë dhe përgjegjësi më të madhe kërkohen njerëz që kanë dije dhe dija paguhet kudo. Unë do ta mbështes propozimin dhe për nivelin e punës që propozimi është i drejtë.

**Blerim Kuçi:** Në propozimin e grupit punues është bërë një gabim, duhet të jetë për “sesionet” e mbajtura dhe ko për “mbledhjet”. Pasi që sesione nënkupton takimi që ka filluar me një agjend të caktuar që mund të zgjatë disa ditë por që konsiderohet një sesion.

**Safete Hadërgjonaj:** Unë pajtohem me Dardanin se këta janë për me krye punë profesionale dhe duhet me qenë njerëzit e përgaditur. Ne kemi qenë të detyruar edhe në të kaluarën, në mungesë të Ligjit për paga që të propozojmë për Kuvendin caktimin e pagave për përfaqësues të institucioneve të pavarura, pasi që nuk ka pasur zgjidhje tjera. Presim që kjo çështje të zgjidhet me miratimin e atij ligji. Propozojë që të miratojmë propozimin e grupit punues me përmirësimet, ku përmendet mbledhje të zëvendësojmë me sesione.

**Mërgim Lushtaku:** Unë pajtohem me shumicën e propozimeve të anëtarëve të komisionit dhe siç u tha për këto komisione të Agjencisë kërkohet një shkollim adekuat, të jenë profesinonal dhe të kenë përvojë të punës dhe në këtë drejtim nuk mund të krahasohet me një punëtor të thjeshtë si u mundua të bëjë krahasime znj. Nagavci, dhe më vjen keq që e thëmë, po nuk është mirë as për Kuvendin dhe as për politikën të diskutohet me hipokrizi dhe mendoj se rekomadimi i grupit punues është i mirë.

**Arbërie Nagavci:** Nuk ka të drejtë zotëria të atakojë dikën për hipokrizi dhe li ti sheh hipokrizit e veta. Ju na paskeni sjellur një dokument zyrtar ku katër herë është thënë për një mbledhje e tash pas reagimit tim po po thoni për sesione. Edhe unë jam e vetëdishme për aspetin profesional në këto komisione dhe duhet të vlerësohet përgaditja profesionale e secilit individ, por duhet pasur kujdes se duhet sjellur dokumente me të dhëna më të sakta për të cilat duhet të votojmë në mënyrë që edhe votimi jonë të jetë i saktë. Në këtë situatë unë kisha thënë le të shtyhet si pikë e rendit të ditës që të na sjellin dokumente të sakta e jo këso pohime aty për aty për çështjet që janë përmbajtësore

**Safete Hadërgjonaj:** Propozojë që të miratojë rekomandimin e Grupit Punues me përmirësimet, që ku përmendet “mbledhje” të zëvendësojmë me “sesione”.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, zëvendëskryetarja e parë, konstatoi se Komisioni me Pesë vota Për, katër Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

### **Propozim – Vendim**

Për caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona

1. Anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore, të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, t'i caktohet kompensimi në shumën prej 700 (shtatëqind) euro, bruto në muaj, për një sesion të mbajtur.
2. Dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendorsje për Prona, të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, iu caktohet kompensimi në shumën prej 700 (shtatëqind) euro, bruto në muaj, për secilin anëtarë, për një sesion të mbajtur.
3. Kompensimet për anëtarin e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarët e Komisionit për Verifikim dhe Vendorsje për Prona, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij rekomandimi, paguhen më së shumti për pjesëmarrje në 10 (dhjetë) sesione, brenda një viti.
4. Niveli i kompensimit për anëtarin e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarët e Komisionit për Verifikim dhe Vendorsje për Prona, sipas pikës 1 deri në 3, të këtij rekomandimi, bëhet nga buxheti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dhe zbatohet deri në miratimin e Ligjit përkatës për pagat.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:05.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----

**Lumir Abdixhiku**